



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

Bulevardi Bill Clinton, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 603 668 • E-mail: fbv@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe Veterinarisë

Departamenti: Mbrojtja e bimëve

Programi: Mbrojtja e bimëve-Fitomedicinë

## NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti ) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja Valon Shabiu, me titull:

**“Flora e barojave të specit të kultivuar në fushë të hapur dhe në serrë”**

ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 18.09.2024 deri me datë 25.09.2024.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. Asoc.dr. Fadil Musa, kryetar
2. Prof. dr. Arben Mehmeti mentor
3. Prof. dr. Skender Kaciu, anëtarë

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonit te udhëheqësi shkencor i temës Prof. dr. Arben Mehmeti, përmes e-mail adresës arben.mehmeti@uni-pr.edu.

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji është mund të jetë një pasurim i punës tonë !



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË**

Bulevardi Bill Clinton, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 603 668 • E-mail: fbv@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"**

**FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË  
PROGRAMI: Msc. MBROJTJA E BIMËVE-FITOMEDICINË**



**PUNIM DIPLOME**

**"Flora e barojave të specit të kultivuar në fushë të hapur dhe në serrë"**

Mentor:

Prof.Dr. Arben Mehmeti

Kandidati:

Bsc.Valon Shabiu

*Prishtinë, shtatorë 2024*



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

Bulevardi Bill Clinton, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 603 668 • E-mail: fbv@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

## ABSTRAKTI

Barojat janë mjaft shum të përhapura në spec dhe shkaktojnë dëme mjaft të mëdha gjatë kultivimit të specit. Nga 32 lloje të barojave të regjistruara në spec ato ju takojnë 16 familjeve, kurse llojet dominante ishin nga familja *Astereaceae* dhe *Poaceae* kurse familjet tjera janë përfaqësuar me më pak lloje. Llojet dominante të barojave në fushë të hapur ishin: *Convolvulus arvensis*, *Amaranthus retroflexus*, *Portulaca oleraceae*, *Galinsoga parviflora*, *Chenopodium album* dhe *Hibiscus trionum* kurse në serrë ishin: *Convolvulus arvensis*, *Portulaca oleraceae*, *Chenopodium album*, *Galinsoga parviflora*, *Amaranthus retroflexus*, dhe *Digitaria sanguinalis*. Numri i barojave në fushë të hapur dhe serrë ishte me dallime të vogal, 27 lloje në fushë të hapur dhe 25 lloje në serrë, por nuk ka pasur dallime signifikante. Nga 32 lloje të barojave të regjistruara në spec, 81.2% janë gjethgjera dhe 18.8% gjethengushta, kurse sa i përket ciklit biologjik 71.9% janë njëvjeçare dhe 28.1% janë shumëvjeçare. Sa i përket formave jetësore, kanë dominuar terofitet më 64.1% dhe hemikriptofitet më 23.4%, pastaj geofitet më 10.9% dhe më së paku kamefitet më 1.6%. Elementet floristike të barojave më së shumti ju përkasin elementeve floristike kosmopolite 37.4%, evropiane 31.3% dhe mediterane 9.4%. Sa i përket elementeve floristike të barojave ka dallime ndërmjet barojave në fushë të hapur dhe serr. Në fushë të hapur dominojn kosmopolitet me 48.2%, kurse në serr dukshëm më pak janë regjistruar me 32.0%. Derisa, në serr numri më i madh i barojave janë evropiane 32.9%, kurse në fushë të hapur 25.9%.

*Fjalët kyçe: barojat, speci, fushë e hapur, serrë*